REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 114/17
Datë/Datum. 18.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

"BOTEK" Sh. P. K. Prishtinë

Nr. i AP: ____ **PK214-16-147-1-1-1**_____
(shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Kundër vendimit të autoritetit kontraktues për eliminimin e kompanisë tonë lidhur me tenderin:

FURNIZIM ME TONERA PËR PRINTERA LOT 1
(shëno titullin e kontratës si në paragrafin II..1 të Dosjes së Tenderit)

të iniciuar nga
Policia e Kosovës
(shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)
në afatin ligjor parashtroj këtë:

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

"BOTEK" sh. p. k.
(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Agim Ramadani Akt .1. objekt c
(Adresa)

10000
(Kodi Postal)

Prishtinë
(Vendi)

038/245-830
(Numri i telefonit)

038/245-625
(Numri i faksit)

Hilmi Asllani
(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@bo-tek.com
(adresa elektronike)

18.04.2017
(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

IT · Communication · Energy
BOTEK sh.p.k.
2003 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(emri i avokatit)

_____

(adresa e plotë)

_____ _____

(numri i telefonit) *(numri i faksit)*

_____

(adresa elektronike)

_____ _____

(data e parashtrimit të ankesës) *(nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Një përshkrim i shkurtër lidhur me datën dhe emrin e gazetës (ve) ditore në të cilën (at) është publikuar " Njoftimi për Kontratë" si dhe "Njoftimi për dhënie të Kontratës", afati i fundit për dorëzimin e tenderit, data dhe ora e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e njoftimit për kontrate: 22.07.2016 Data e dorëzimit të tenderit: 24.08.2016 Data e njoftimit për tenderuesin e eliminuar: 04.04.2017 Kriteri për dhënie te kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [X] **Jo** [ ]

Me date 07.04.2017 kemi bere kërkesën për rishqyrtim, kërkese qe na është refuzuar nga AK.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë e gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës:

Neni 6. 7. 35 dhe 59

*** Sipas nenit 113 të LPP-së, OSHP-ja do të konfiskoj Sigurimin e Ankesës tuaj, nëse Paneli Shqyrtues konstaton se të gjitha apo cilado nga pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë të rrejshme apo mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

DEKLARATA ne Ankesë dhe Seancë

Gjatë vlerësimit të tenderit, AK-Policia e Kosovës me datë 09.09.2016 e kishte Ri-konfirmuar validitetin dhe Origjinalitetin e Autorizimit (DAF) të lëshuar nga ALSO Internacional për Botek shpk për këtë procedurë të prokurimit, 214-16-147-111, me titulli: *"Furnizim me tonerë për printer – Pjesa 1"* dhe (kjo është Ri-konfirmuar nga AK, Ekspertët dhe vetë OSHP).

- Duke marrë parasysh faktin se OSHP në *"Vendimin e datës 23.02.2017 – PSH. Nr. 466/16"* , **Prova 1)** aprovon si pjesërisht të bazuar ankesën e OE- Botek shpk, duke anuluar vendimin lidhur me njoftim për dhënien e kontratës e obligon që Autoriteti Kontraktues, në afat prej 10 ditësh të njoftoj Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

- Duke marrë parasysh se, AK (Policia e Kosovës) në "Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar" e dërguar me 04/04/2017 (pra 40 ditë pas këtij vendimit të OSHP), arsyetohet për të eliminuar OE- Botek me pretendime se:

- *Autorizimi nga prodhuesi / dileri i autorizuar për shitje te mallit.-**Autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje te mallit** – Kemi kërkuar sqarime nga lëshuesi i autorizimit ALSO Internacional B.V. për shitje të produkteve HP, Canon & Samsung, i cili në përgjigjen e dhënë thekson se nuk thekson se autorizimet e tije mundë të përdorën vetëm në bashkimin evropian dhe jo në vendet tjera. po ashtu edhe prodhuesi HP nuk konfirmon se është tërhequr apo jo autorizimi nga distributori* **(Prova 2,** *"Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar")***.**

Ne kundërshtojmë fuqishëm si të pabazuar Vendimin e AK për eliminim të kompanisë sonë, duke u bazua në faktin se AK-Policia e Kosovës edhe pas shumë përpjekjeve të paautorizuara dhe kërcënuese, nuk ka pranuar në asnjë formë elektronike apo postare, **Tërheqje Formale të Autorizimit nga Distributori ALSO Internacional.**

Pra, në bazë të vendimit të OSHP-së (PSH. Nr. 466/16), OSHP-ja pasi qartëson se **nuk gjeti se ka tërheqje zyrtare të autorizimit të lëshuar nga ky distributor e as nga prodhuesit HP,** e kishte rekomanduar AK-Policinë e Kosovës - ***të kontaktoj prodhuesin HP që të sqaroj situatën rreth Autorizimit në fjalë dhe po ashtu të sqarohet se edhe a ekziston ndarja e tregjeve në HP por nuk e kishte rekomanduar AK të kontaktoj dhe ushtroj presion jashtëligjshëm mbi distributorin ALSO Internacional ".***

Nga shkresat e lëndës duhet të konstatojmë se, pas komunikimit të AK-Policia e Kosovës me përfaqësuesin e HP-se z. Bojan Grubac, ky i fundit sqaron se *"meqenëse ALSO Internacional nuk është pjesë e HP-se ata edhe nuk mund te japin informata shtesë se a ekziston apo jo ndonjë Tërheqje Formale e Autorizimit. Po ashtu me anë të këtë letër konfirmim të HP-së precizohet se...në bazë të rregullores dhe kodit të sjelljes dhe bërit biznes të prodhuesit HP, decidivisht është e ndaluar ndarja e tregjeve"* ***(Prova 3,*** *"korrespodenca në mesë AK dhe prodhuesit HP)***.**
Për sa i përket pyetjes mbi ndarjen e tregjeve edhe në bazë të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës të Republikës së Kosovës, *Neni 4,* **si "Marrëveshje të Ndaluara",** *Pika 1.3* precizon qartë – ***"ndalohet ndarja e tregjeve ose burimeve të furnizimit".*** **(PROVA 4,** *"Ligji për mbrojtjen e konkurrencës NR. 03/L-229").*

IT · Communication · Energy
BOTEK sh.p.k.
Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

Me këtë komunikim ndërmjet AK dhe HP-së si dhe duke i pas për bazë Ligjet e Kosovës, AK do të duhej të përmbyllte procedurën e Ri-vlerësimit të këtij tenderit duke u bazua në *"Vendimin mbi dhënien e kontratës nga AK, dt. 23.09.2016"*, **PROVA 5),** si dhe Vendimin të fundit të OSHP-se dt. 23.02.2017, ku konstatohet se... ***"në shkresat e Lëndës NUK kishte asnjë Dok që konfirmon - Tërheqjen të Autorizimit nga distributori ALSO Intern e as nga prodhuesi HP",*** dhe rrjedhimisht çështja e validiteti të autorizimit (DAF) për kompaninë tonë NUK do duhej dhe nuk mund të kontestohet nga AK.
Vlerësimi i Validitetit të çfarëdo DOK të dorëzuar duhet të bëhet në momentin e lëshimit dhe dorëzimit të tij (kjo ishte Ri-konfirmuar nga vet AK) dhe me këtë rast i gjithë procesi do të duhej të kthehej ne pikën ZERO, pra në momentin fillestar të dorëzimit dhe vlerësimit të Dokumenteve të dorëzuara nga OE.

Mirëpo, përkundër gjithë këtyre fakteve, AK - Policia e Kosovës për arsye ende të pa sqaruara apo edhe me tendencë të paramenduar shkon, përtej këtij vendimi të OSHP-se, Ligjeve të LPP dhe Ligjit për mbrojtjen Konkurrencës si dhe në kundërshtim me vet Vendimin e tyre fillestarë si AK, duke dërguar dhe Ri-dërguar e-mail-kërcënues dhe shantazhe distributorit ALSO Internacional me qëllim të vetëm që të gjejë ndonjë fjali sado negative për të eliminuar qëllimisht kompaninë tonë BOTEK shpk.

Këto komunikime me e-mail të z. Hyseni (zyrtarë i prokurimit në Policinë e Kosovës) drejtuar distributorit ALSO Internacional, përveç faktit se nuk ishin të autorizuara nga OSHP- ja, për vlerësimin tonë përmbajnë një gjuhë kërcënuese /shantazhi të papranueshme duke mos qenë gjithashtu i autorizuar nga vet AK (**PROVA 6.** , *"korrespodenca në mesë AK dhe Distributorit ALSO Internacional"*).

Ky komunikim dhe këta e-maila të cilët PK i ka pranuar prapëseprapë nuk përbëjnë asnjë dokument zyrtare siç kërkohet në vendimin e OSHP-se, me të cilin do të bëhej "Tërheqja Formale e Autorizimit", në bazë të cilit eventualisht do të mund të eliminohej oferta e kompanisë sonë Botek shpk.

Qartësisht, në e-mailin e datës 01.03.2017 të dërguar nga z. Enver Hyseni (zyrtarë i Prokurimit) dhe drejtuar Mr. Jeroen Verouden nga ALSO Internacional, insistohet me ngulm dhe kërkohet nga ky distributorë që të dërgohet një dokument zyrtar i nënshkruar, i vulosur dhe skanuar, ku konfirmohet apo jo autorizimi i ALSO Internacional i lëshuar për kompaninë tonë Botek shpk.
Këtë dokument "të kërkuar me ngulm dhe me të gjitha mjetet ng AK - nuk e ka pranuar deri me sot.

Duhet shtuar se, AK-Policia e Kosovës, ka qenë i obliguar që brenda 10 ditëve të njoftoj Panelin Shqyrtues për veprimet e ndërmarra. Këtë Vendim AK po ashtu nuk e ka Respektuar duke filluar komunikimet për të cilat rekomandohet nga OSHP pas më shumë se një muaji pas vendimit të OSHP-së.
E gjithë kjo zvarritje si dhe zvarritja në arritje të vendimit për eliminim është bërë në mënyrë të jashtëligjshme dhe qëllimshmit në mënyrë që të dëmtohet kompania jonë Botek shpk.
E-mail i parë drejtuar ALSO Internacional ka qenë me 01. Mars të këtij viti ndërsa i fundit me 28. Mars 2017. E gjithë kjo vonese / zvarritje është shkaktuar vetëm e vetëm për të gjet pra ndonjë fjali apo fjale që do të mund të keqinterpretohej negativisht në disfavor të kompanisë Botek shpk.

Përfundimisht, pas gjithë këtyre zvarritjeve dhe përpjekjeve të jashtëligjshme të AK, **NUK ka tërheqje formale te autorizimit dhe duke u bazuar në këtë Fakt, rrjedhimisht NUK ka edhe ndonjë arsyetim valid për eliminimin e kompanisë Botek shpk për këtë**

IT-Communication Energy 2003 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015
BOTEK sh.p.k.

procedurë të prokurimit. Po ashtu vërtetohet se HP nuk ka ndarje te tregjeve prandaj një autorizim valid i HP vlen për te gjitha vendet ku mund te shitet HP-ja.

Prandaj duke marrë për bazë të gjitha këto fakte të pamohueshme , kërkojmë nga ju si Panele Shqyrtues që kjo procedure e prokurimit të kthehet sërish në Ri-vlerësim duke obliguar AK (Policinë e Kosovës) që pas gjithë këtyre muajve dhe zvarritjeve të panevojshme dhe jashtëligjore lëndën ta kthej në pikën fillestare dhe ligjore duke marrë për bazë Validitetin e Dokumenteve në Kohën e vlerësimit fillestarë të dokumenteve Administrative dhe ofertave teknike e Financiare dhe duke u mbështet ne Ligjet e aplikueshme ne Kosovë si ai i LPP dhe Ligji për mbrojtjen e Konkurrencës.

Në rast si fillohet të merren për bazë shkresa joformale të personave të ndryshëm nga prodhues dhe Distributorë të ndryshëm dhe të futen në procedurë të Rivlerësimeve atëherë KJO do të duhej të lejohej nga të gjitha palët ne Procedurë dhe jo njëanshëm.

Pra, nëse lejohet që sot (6 muaj më vonë) të vlerësojmë dokumente dhe shkresa shtesë, nëse një OE i përmbushë apo jo kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit SOT (ashtu sikurse AK po provon me çdo kusht dhe të gjitha mjetet joligjore të arrij), atëherë NE duam të qartësojmë Faktin se sikurse edhe ne Ankesën e Fundit ku ne kemi dorëzuar Dok/ Konfirmimin se jemi partner legal dhe kemi mbështetje direkt nga prodhuesi HP, edhe sot në këtë seancë duam ta RI-konfirmojmë faktin se kompania BOTEK e ka mbështetjen e plotë dhe direkte nga prodhuesi HP për këtë tender.

Ne kemi pranuar këtë mbështetje ligjore dhe Parimore nga HP të cilët edhe me DOK. (MAF) ekskluzivisht të dedikuar për këtë Seancë e Ri- Konfirmojn se kompania BOTEK si Partner i HP-së e ka mbështetje të plotë për të realizua me sukses këtë projekt (**Dok. MAF** dhe dok. të tjera që konfirmojnë këtë mbështetje do t'i prezantojmë direkt në Seancën Kryesore të PSH.

Ne vlerësojmë se të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe gjithë ne si OE jemi të obliguar dhe duhet të i nënshtrohemi vetëm dhe vetëm Ligjeve të Kosovës dhe nuk guxojmë të lëshohemi në situata të paqarta juridike duke ra në lajthitje dhe pre e shkresave dhe deklarimeve tendencioze, e-mailave jo formal si dhe Interesave të individëve dhe grupeve të caktuara, si në këtë rast, atëherë do lejohej të shkeleshin rëndë LPP, por edhe ligje tjera të aplikueshme në Kosovë si dhe do të dëmtohej rëndë Integriteti i OSHP-së si organ i Pavarur Vendimmarrës dhe Përmbarues.

- Pra, cili është MOTIVI dhe Interesi i kujt po e detyron AK që me të gjitha mjetet legale dhe Jo-legale të kërkoj me ngulm që Dokumentin (DAF) origjinal dhe Validë sipas FTD, të dorëzuara nga ne si OE dhe i Ri-konfirmuar nga vetë AK, ta nxjerrin sot 6 muaj ma vonë si të Pavlefshëm ?
- Qfar Interesi qëndron prapa këtyre përpjekjeve marramendëse të AK për të arritur këtë qëllim negativë dhe ne kundërshtim me Vendimet e tyre si AK, qoftë edhe veprime të jashtëligjshme ?

Duke marrë për bazë të gjitha këto Fakte të pamohueshme por edhe fakte të tjera që mbështesin Pretendimet tona Ligjore, Paneli Shqyrtues kërkojmë të merr një Vendim meritorë duke Rikthyer këtë procedurë në Ri-Vlerësim, plotësisht komform LPP-se, Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës Nr. 03/L-229 si dhe duke mbrojtur parimet themelore të tregut të lirë.

IT Communication · Energy · BOTEK sh.p.k. · 2003 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Nga humbja e kësaj kontrate kompania jone ka shpenzuar jashtëzakonisht shumë si mbrojtja ligjore nga avokatë të autorizuar, përgatitjet e disa procedurave ankimore deri tani, humbja fitime financiare të planifikuara si dhe më e rëndësishme se këto aspekte financiare kjo do të ishte një precedent absolutisht I rrezikshëm ne kundërshtim me LPP dhe Ligjet tjera të aplikueshme ne Kosovë.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

kërkojmë të merr një Vendim meritorë duke Rikthyer këtë procedurë në Ri-Vlerësim, plotësisht komform LPP-se, Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës Nr. 03/L-229 si dhe duke mbrojtur parimet themelore të tregut të lirë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Regjistroni secilën dëshmi të cilën do t'i bashkëngjitni ankesës tuaj. Në mënyrë që ankesa juaj të merret në shqyrtim, duhet të ketë të bashkangjitur patjetër ***Publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës*** *me të cilën do të dëshmohet data si dhe emri i gazetës në të cilën është publikuar ky njoftim apo njoftimin e kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar, procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, si dhe të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

1. Deklarata mbi faktet dhe argumentet. 2. Hapja e tenderit 3. Njoftimi për tenderuesin e eliminuar 4. Vendimin për shqyrtimin e ankesës - Refuzim, 5. Flete pagesa

*** Sipas nenit 106.2 të LPP-së, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe më pas një kopje të protokolluar nga OSHP-ja do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*